


Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Janar, 2017

Tiranë, më 21 Shkurt 2017: Numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj të hyrë në territorin shqiptar, në muajin Janar 2017 është 462.812. Krahasuar me Janar 2016, ky tregues rezulton me rritje 0,5 %. Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vend është 172.757. Krahasuar me Janar 2016, ky numër është ulur me 0,4 %. Shtetasit shqiptarë dhe të huaj të dalë nga vendi gjatë muajit Janar 2017 janë 558.109, duke shënuar një ulje me 4,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë muajit janar 2017 është 371.041. Krahasuar me Janar 2016 ky numër është ulur 1,3 %.

Fig. 1 Hyrje-daljet e shtetasve në Shqipëri



Tab.1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Jan-16	Jan-17	Ndryshimi në Përqindje
Hyrje Gjithsej	465.812	468.162	0,5
Shqiptarë	292.278	295.405	1,1
Të Huaj	173.534	172.757	-0,4
Dalje Gjithsej	581.084	558.109	-4
Shqiptarë	375.904	371.041	-1,3
Të Huaj	205.180	187.068	-8,8

Numri i vizitorëve të huaj, të hyrë në Shqipëri për qëllime pushimi dhe vizita ditore në muajin Janar 2017, rezulton 30.374, ndërsa në Janar 2016 ky numër ishte 15.714.

Në Shqipëri, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë për qëllime personale në Janar 2017 është 169.822 dhe përbëjnë 95 % të numrit gjithsej të hyrjeve të shtetasve të huaj. Krahasuar me Janar 2016, numri i shtetasve të huaj për qëllime personale është ulur 0,7 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri për qëllime biznesi përbën 0,5 % të hyrjeve të shtetasve të huaj, duke shënuar rritje me 14,3 %.

Tab.2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Jan-16	Jan-17
Hyrje Shtetas të Huaj	173.534	172.757
I. Personale	170.966	169.822
1. Pushime	14.309	17.617
2. Vizitë në miq e të afërm	1.322	526
3. Vizitë ditore	1.405	12.757
4. Trajtim shëndetësor	64	43
5. Qëllime fetare	78	26
6. Vizitorë të tjerë	139.760	130.245
7. Udhëtarë transit	14.028	8.608
II. Biznes dhe profesionale	2.568	2.935


Hyrjet e shtetasve të huaj, në rrugë tokësore zënë peshën më të madhe me 75,9 %, ndërsa hyrjet në rrugë ajrore dhe detare zënë respektivisht 19,3 % dhe 4,8 %.

Tab.3 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Jan-16	70.554	25.278	369.980	79.098	55.388	446.598
Jan-17	90.437	22.421	355.304	102.900	55.129	400.080
Ndryshim Vjetor	28,2	-11,3	-4	30,1	-0,5	-10,4

Numri më i madh i hyrjeve të shtetasve të huaj në vendin tonë, në muajin Janar, rezulton nga Kosova me 33,3 %, pasuar nga hyrjet e shtetasve të huaj nga Maqedonia me 14,6 %, Greqia me 13,6 %, Mali i Zi me 12,0 %, etj.

Fig.2 Shtetet me hyrjet më të mëdha në Shqipëri



Metodologji

Përkufizime:

Vizitorë: Për qëllime të statistikës së turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Hyrjet : Përfshijnë të gjitha hyrjet në kufi.

Hyrjet është një koncept që i referohet të gjitha arritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re

Daljet : Përfshijnë të gjitha daljet në kufi. Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës.

Qëllimi kryesor i vizitës është qëllimi pa të cilën udhëtimi nuk do të kryhej. Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për arsye:

Vizitat për *qëllime personale*

1. Pushime
2. Vizitë në miq e të afërm
3. Vizitë ditore
4. Trajtim shëndetësor
5. Qëllime fetare
6. Vizitorë të tjerë
7. Udhëtarë tranzit

Kategoria e biznesit përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Policisë së Shtetit).

Të dhënat e muajit të fundit janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.